

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE

DREJTORIA E PROKURIMEVE ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMEVE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT¹)

OPERATORIT EKONOMIK “ONE ALBANIA” SHA
RRUGA “MUHEDIN LLAGAMI” KOMPLEKSI SQUARE 21, TIRANË

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar (shërbim)
(marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-84262-10-18-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Ofrimi i shërbimit online për monitorimin e trafikut
urban në Bashkinë Tiranë”** për nevoja të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 87 datë 23 Tetor 2023

Publikimet e mëparshme (njoftimi i fituesit paraprak): Buletini Nr. 4 datë 29 Janar 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

➤ **OPERATORI EKONOMIK “VODAFONE ALBANIA” SH.A NIPT: K11715005L**

Vlera e ofertës pa tvsh = 40,563,341 (dyzet milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e dyzet e një) lekë.

➤ **OPERATORI EKONOMIK “ONE ALBANIA” SH.A NIPT: J61814094W**

Vlera e ofertës pa tvsh e korrigjuar 40,383,527 (dyzet milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit është s’kualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

➤ **OPERATORI EKONOMIK “VODAFONE ALBANIA” SH.A NIPT: K11715005L**

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 pika 2 e VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si vijon:

- I. Autoriteti Kontraktor, në Shtojcën 2 “*Lista e Cmimeve të Shërbimeve*”, (Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik), pjesë e Dokumentave Standarde të Tenderit për këtë procedurë objekt vlerësimi ka bashkëlidhur edhe listën preventive (pa vlerë) me të gjithë zërat dhe tipologjitë e shërbimit (Internet, Dark Fiber, Data Sim Card), objekt kontrate .

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga Operatori Ekonomik “Vodafone Albania” sh.a për përmbushjen e Shtojcës 2, “*Lista e Cmimeve të Shërbimeve*”, pjesë e DST, rezulton se në plotësimin e Shtojcës 2, operatori ekonomik nuk i është përmbajtur formatit të preventivit (pa vlerë) të publikuar nga AK si pjesë përbërëse e Shtojcës 2 të Dokumentave Standarde të Tenderit të kësaj procedure prokurimi objekt vlerësimi, por ka ofertuar një çmim të përmbledhur nën zërin “*Dark FO, SIM*”.

Duke marrë shkak se tipologjia e shërbimeve, objekt kontrate është e ndryshme, çmimi i ofertuar në total e bën të pamundur identifikimin e çmimeve për secilën tipologji. Ndër të tjera vlen të përmendet gjithashtu se duke qenë se tipi i përzgjedhur i kontratës është “Marrëveshje Kuadër” dhe kërkesat për shërbime do të bëhen sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, oferta sipas Listës së Çmimeve pjesë e Shtojcës 2 të DST është tejet e rëndësishme.

Referuar sa më sipër, K.V.O gjykon se Operatori Ekonomik “Vodafone Albania” sh.a nuk përmbush Shtojcën 2 (Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik), pjesë e Dokumentave Standarde të Tenderit.

- II. **Autoriteti Kontraktor në pikën 1/b të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit të dokumentave standarde të tenderit, përcakton se:**

“ 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

”

Operatori Ekonomik “Vodafone Albania” sh.a nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për përmushjen e pikës 1/b të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit

Sa më sipër, KVO konkludon se operatori ekonomik “Vodafone Albania” sh.a nuk ka përmbushur kriterin 1/ b pjesë e kritereve të vecanta të kualifikimit, si dhe shtojcën 2 të dst.

Sa më sipër, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit **Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”**, dhe të Kreut X, Nenit 82 pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon njëzëri se oferta e Operatorit ekonomik “Vodafone Albania” sh.a nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë të pavlefshme.**

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si i suksesshëm:

- **OPERATORI EKONOMIK “ONE ALBANIA” SH.A NIPT: J61814094W**

Vlera e ofertës pa tvsh e korrigjuar 40,383,527 (dyzet milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH .

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____